REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË

NJOFTIM PËR QYTETARËT

MBI MUNDËSINË E APLIKIMIT NË KUADËR TË "PAKETËS SË MALEVE"

Date 09/11/2026

BASHKIA KOLONJË

Bashkia Kolonjë informon të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara mbi mundësinë e aplikimit në kuadër të nismës "Paketa e Maleve", bazuar në Ligjin nr. 20/2025 "Për Paketën e Maleve".

Kjo nismë synon të nxisë zhvillimin ekonomik, investimet dhe rigjallërimin e zonave malore, duke krijuar mundësi për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, turistike, bujqësore dhe blegtorale.

Në këtë kuadër, qytetarët dhe subjektet që pretendojnë se plotësojnë kriteret ligjore për njohjen si posedues jopronarë të pasurive në zonat e përfshira në këtë program, ftohen të paraqesin aplikimin dhe dokumentacionin përkatës.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM

Në mbështetje të procedurave përkatëse, aplikantët duhet të disponojnë dokumentacion që provon posedimin dhe lidhjen e tyre me pasurinë, si:

1. Plan rilevimi të sipërfaqes së pretenduar.
2. Dokumentacion tatimor që provon ushtrimin e aktivitetit ekonomik mbi pronën, nëse disponohet.
3. Fatura të shërbimeve të lidhura me pronën, nëse disponohen.
4. Deklarata ose dëshmi nga banorë dhe autoritete vendore që konfirmojnë përdorimin e vazhdueshëm dhe të pandërprerë të pronës për të paktën 10 vjet.

5. Fotografi, ortofoto ose prova të tjera materiale që vërtetojnë posedimin dhe lidhjen me pasurinë.
6. Dokumentacion tjetër mbështetës, sipas rastit dhe kërkesave të procedurës ligjore.

MËNYRA E APLIKIMIT

Aplikimi kryhet nëpërmjet portalit qeveritar **e-Albania**, në shërbimin:

"Aplikim për Paketën e Maleve"

Linku për aplikim:

Paketa e Maleve

Aplikantët duhet të identifikohen në portal, të zgjedhin shërbimin përkatës, të plotësojnë formularin elektronik dhe të ngarkojnë dokumentacionin mbështetës.

INFORMACION DHE ASISTENCË

Për informacione të mëtejshme dhe orientim lidhur me procedurën e aplikimit, qytetarët mund t'i drejtohen Bashkisë Kolonjë.

Bashkia Kolonjë fton të gjithë të interesuarit të informohen dhe të ndjekin procedurat përkatëse, me qëllim shfrytëzimin e mundësive që ofron kjo nismë për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave malore.